

Kërcet kallashnikovi në Uglarë të Gjilanit: Pas rrahjes, i dyshuari shkon dhe i gjuan familjarët viktimës

LAJME



21/11/2023 09:39



Një rast i konfliktit mes dy personave ka mundur të përfundojë me fatalitet dje në fshatin Uglarë të Gjilanit.

Policia bën me dije se janë arrestuar dy të dyshuar të cilët për shkak të një mosmarrëveshje janë përfshirë në përleshje fizike, shkruan [lajmi.net](#).

Më pas njëri nga të dyshuarit kishte marrë nga shtëpia e tij një armë automatike dhe kishte shkuar te shtëpia e të dyshuarit tjetër dhe kishte gjuajtur me armë në drejtimi të shtëpizave të tij dhe familjarëve të tij.

Si pasojë e përdorimit të armës nga predhat e fishekëve të armës janë goditur shtëpitë e të dyshuarit dhe një veturë e parkuar.

Lidhur me rastin në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë relevante policore.

Nga njëri prej të dyshuarve është sekuestruar një pushkë automatike me 21 copë fishekë.

Me vendim të prokurorit i dyshuari i cili e ka përdorur armën është dërguar në mbajtje, kurse i dyshuari tjetër është liruar në procedurë të rregullt. [/Lajmi.net/](#)

Artikuj të ngjashëm



November 21, 2023

Personat që shpërthyen bankomatin në Gjilan kishin veturë me targa të...



November 21, 2023

Policia jep detaje për zjarrin brenda IML-së



November 21, 2023

Gjendet pa shenja jete në shtëpinë e tij, dyshohet se kreu vetëvrasje



November 21, 2023

E kërcënoi me publikim të fotove intime e vrasje, arrestohet nga policia



November 21, 2023

Digjet një zyre brenda IML-së




November 21, 2023

Buxheti i vitit 2024 diskutohet në dy komisionet parlamentare

LAJME TË FUNDIT



Alby, Monika, Edona, Lumbardhi, Linda dhe Vesa janë...



Personat që shpërthyen bankomatin në Gjilan kishin veturë...



Policia jep detaje për zjarrin brenda IML-së



Gjendet pa shenja jete në shtëpinë e tij, dyshohet se kreu vetëvrasje